

VENDIM
Nr. 1002, datë 13.11.2013

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve ndërmjet programeve buxhetore në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Forcat e luftimit”, zëri “Shpenzime korente”, të pakësohet fondi 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë;

b) Në programin “Arsimimi ushtarak”, zëri “Shpenzime korente”, të pakësohet fondi 42 500 000 (dyzet e dy milionë e pesëqind mijë) lekë;

c) Në programin “Bashkëpunimi civilo-ushtarak”, zëri “Shpenzime korente”, të pakësohet fondi 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë;

ç) Në programin “Mbështetja e luftimit”, zëri “Shpenzime korente”, të shtohet fondi 63 500 000 (gjashtëdhjetë e tre milionë e pesëqind mijë) lekë.

2. Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama